

22 Gusht 2011

## Mbrojtja e të Dhënave Personale në Kosovë

Mentor Vrajolli & Sofije Kryeziu

### Përmbledhja

Ky raport ka për qëllim që të demonstroj nevojën e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. Rëndësia e implementimit të këtij ligjit qëndron në faktin se ky ligj është i ndërlidhur drejtpërsëdrejti me fusha tejet të rëndësishme si: mbrojtja e të drejtave të njeriut, e drejta penale dhe ajo e procedurës penale, anti-korrupsioni, telekomunikacioni, regjistrimi civil, sektori privat si dhe me fusha tjera të rëndësishme të ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë raport janë ngritur shqetësime të konsiderueshme në lidhje me implementimin e legjislacionit në këtë fushë. Po ashtu, raporti ka vërejtur se mungon harmonizimi i legjislacionit që rregullon këtë fushë me legjislacionin tjetër ndërlidhës. Kjo për shkak se një pjesë e legjislacionit përcjellës është nxjerrur para miratimit të këtij ligji, gjë që lë hapsirë për kundërthënje sa i përket harmonizimit me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Raporti nënvizon po ashtu se disa procese tejet të rëndësishme të koleksionimit të dhënave personale janë ndërmarrë vitin e fundit pa marrë në konsideratë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, edhe pse ky ligj ishte në fuqi. Andaj, qëllim kryesor i këtij raporti është nxitja e akterëve kryesor si dhe i opinionit publik që të ndërmarrë masat e domosdoshme në implementimin sa më të shpejtë të legjislacionit në këtë fushë. Një gjë e tillë gjenë edhe më tepër shtytje sidomos kur dihet se vetëm një numër i vogël i zyrtarëve që punojnë në administratë publike apo në institucione private të thirrura në mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave personale kanë njohuri për ekzistimin e këtij ligji. Raporti po ashtu ka për qëllim që të shërbej si identifikues i problemeve në fushën e të dhënave personale për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale – (e cila sapo është formuar dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe është në funksionalizim e sipër.

Ky është publikimi i dytë i QKSS-së që elaboron zhvillimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë. Publikimi del në përputhje me vizionin strategjik të QKSS për 2011-2013 që përcakton zgjerimin e kapaciteteve hulumtuese edhe në çështjet e drejtësisë në mënyrë që të komplementohen përpjekjet hulumtuese aktuale në çështjet e sigurisë. Ekipi dëshiron të falenderoj mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur – “Think Tank Fund” për mundësimin e hulumtimit dhe publikimit. Përveç kësaj, vlen të theksohet mbështetja e përgjithshme institucionale e “Think Tank Fund” me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve dhe aftësive të hulumtuesve të QKSS-së.

### Metodologjia

Për shkruarjen e këtij dokumenti të politikave stafi hulumtues i QKSS-së është bazuar kryesisht në përdorimin e metodave kualitative, siq janë zhvillimi i intervistave me zyrtarë të ndryshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave si dhe vlerësimi dhe analizimi i dokumente të ndryshme në kuadër të kornizës ligjore dhe i raporteve të ndryshme të publikuara në këtë fushë.

### Pse të Mbrohen të Dhënat Personale?

<<<

**P**rocesi i mbrojtjes së të dhënave personale është standard i cilësuar si mjaft i rëndësishëm si në nivel vendor ashtu dhe në atë ndërkombëtar, implementimi i së cilës dita ditës është duke u bërë pjesë a agjendës ditore për shumicën e vendeve demokratike. Nevoja për mbrojtjen e të dhënave personale ka ardhur si rezultat i zhvillimit të përshpejtuar të teknologjisë informative. Duke marrur si krahasim format tradicionale të grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të cilat pothuajse tërësisht arkivoheshin në mënyrë analoge, teknologjia e re ka transformuar pothuajse tërësisht konceptin e grumbullimit dhe ruajtjes së këtyre të dhënave.

Tani më pajisjet e teknologjisë moderne si kompjuterët, rrjetet e internetit, incizimet audio dhe video etj, janë shëndrruar në mjetet kryesore për grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Favorizues i këtij zhvillimi në fushën e teknologjisë informatike ishte ulja e vazhdueshme e çmimit në treg i këtyre pajisjeve si rezultat i rritjes së ofertave në treg duke e bërë të mundur posedimin e tyre për pothuajse çdo individ. Kjo qasje e lehtë e posedimit të këtyre pajisjeve ka rezultuar në rritje të numrit të aktorëve të përfshirë në procesin e grumbullimit, ruajtjes apo përdorimit të të dhënave personale si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Në fakt, në ditët e sotme me teknologjinë e re, është bërë shumë lehtë dhe jashtëzakonisht lirë që çdo person fizik apo juridik mund të ketë qasje në të dhëna personale duke krijuar databaza për grumbullimin e të dhënave të rëndësishme personale.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh shtimin e vazhdueshëm të dinamikës në punë e si rrjedhojë përshpejtimin e shkëmbimit të informatave, është bërë pothuajse e pamundur shmangia nga ekspozimi i të dhënave personale. Ekspozimi i të dhënave personale fillon që nga zyrat e regjistrimit civil (regjistrimi i lindjeve, nxjerrjes së letërnjoftimeve, pasaportave e certifikatave të lindjes), zyrat e regjistrimit të bizneseve, plotësimi i formave për aplikime të ndryshme, dorëzimi i CV-ve, hapja e llogarive bankare ose e-mail adresave, blerja e numrit telefonik, regjistrimi në rrjete të ndryshme sociale, E-marketing, regjistrimi gjatë hyrjeve nëpër ndërtesa, gjatë regjistrimit të pjesëmarrjes nëpër konferenca, gjatë kontrollit kufitar, gjatë identifikimit policor, vëzhgimi me kamera dhe shumë të tjera.

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e situatave me të cilat pothuajse çdo qytetar obligohet që ti ekspozoj të dhënat personale, mund të thuhet se përveç aspekteve pozitive që ka sjellur lehtësimi i komunikimit sidomos në efikasitetin e shfrytëzimit të kohës dhe zvogëlimin e shpenzimeve, këto zhvillime kanë pasur edhe ndikime negative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pjesa negative e këtij zhvillimi ka të bëjë sidomos me ekspozimin e të dhënave të rëndësishme private, zbulimi i të cilave mund ti dëmtojë interesat personale të atyre atyre individëve apo kompanive.

Duke pasur parasysh se zhvillimi teknologjik në fushën e teknologjisë informatike është koncept global i cili nuk ka kursyer askënd, padyshim mund të thuhet se edhe Kosova dhe qytetarët kanë qenë dhe mbeten përcjellëse të këtyre zhvillimeve. Kështu, edhe pse vendit tonë i mbeten shumë sfida për ti tejkaluar në rugëtimin e ndërtimit të shtetit dhe përmirësimin e mirëqenies ekonomike, kjo nuk to të thotë njëkohësisht se guxohet të shpërfilltet mbrojtja e atyre të drejtave që mund të konsiderohen madje për secilin individ e që kanë të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë në përgjithësi. Në fund fare, duke pasur parasysh faktin që tanimë Kosova ka miratuar ligjin përkatës që rregullon këtë fushë, është e domosdoshme që përmes analizave dhe hulumtimeve të synohet që të vetëdijësohet opinioni i gjërë për nivelin e implementimit të mbrojtjes së të dhënave personale si dhe rëndësinë që kjo fushë paraqet. Thënë më konkretisht, nisur nga perspektiva bashkëkohore, mbrojtja e të dhënave personale është po aq e rëndësishme sa edhe të gjitha drejtat tjera elementare të njeriut andaj trajtimi i tyre edhe në Kosovë duhet të jetë i njëjtë.

## Rëndësia e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në kontekstin e Kosovës: Rruga drejt Integritimit Evropian <<<

**S**hikuar nga perspektiva e integritimit Evropian, mbrojtja e të dhënave personale paraqet prioritet të veçantë për Bashkimin Evropian (BE).<sup>1</sup> **Direktiva 95/46 KE e miratuar më 24 Tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave** e cila është ende në fuqi, përfaqëson një përpjekje tejet të rëndësishme të ndërmarrë nga Komisioni Evropian për të harmonizuar format dhe mënyrat e mbrojtjes së të dhënave personale në tërë Bashkimin Evropian (BE). Në përputhje me këtë dokument, shtetet anëtare të BE-së obligohen që ti mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik, dhe në veçanti të drejtën e tyre për privatësi e që janë të ndërlidhura me përpunimin e të dhënave personale pa pasur për qëllim kufizimin apo edhe ndalimin e lëvizjes së lirë të këtyre të dhënave ndërmjet shteteve anëtare (Neni 1). Direktiva në fjalë kërkon që çdo shtet anëtar i BE-së ti përshtas rregulloret dhe legjislacionin vendor në përputhje me këtë dokument (Neni 4). Për më tepër kjo direktivë parasheh gjithashtu mënyrën e adresimit të çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, ky dokument ligjor potencon kujdesin që duhet pasur gjatë zbulimit të të dhënave që mund të cilësohen si tejet të ndjeshme, si origjina racore ose etnike, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, anëtarësimi në sindikata, gjendja shëndetësore, jeta seksuale etj. Ajo po ashtu saktëson se të dhënat për veprat kriminale dhe mënyrën e kryerjes së këtyre veprave mund të përdoren por vetëm nën kushte të caktuara në mënyrë strikte (Neni 8).<sup>2</sup>

Për ta elaboruar edhe më tutje rëndësinë që ka mbrojtja e të dhënave personale, duhet analizuar edhe procesin e liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në fakt, një nga kërkesat kryesore të përcaktuara nga Udhërrefyesi për Regjim të Lirë të Vizave me këto shtete nga ana e BE-së ishte edhe nxjerrja e dokumenteve të pajisura me të dhëna biometrike të lexueshme nga makinat përkatëse në përputhje me standardet e ICAO (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) dhe EC (Rregullorja e Këshillit) ku kërkohet futja graduale e të dhënave biometrike krahas fotografisë dhe shenjave të gishtërinjëve (Udhërrëfytyesi për regjim të lirë të vizave, 2009). Përveç kësaj, këtyre vendeve i është kërkuar të miratojnë legjislacionin në këtë sferë (në qoftë se nuk

<sup>1</sup> Karen Mc Cullagh, A study of data protection: harmonization or confusion?, University of Manchester, 2006, <http://www.bileta.ac.uk/Document%20Library/1/Data%20protection%20-%20harmonisation%20or%20confusion.pdf>

<sup>2</sup> Direktiva 95/46 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e miratuar më 24 Tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

është miratuar më parë) si dhe të themelojnë Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga kjo del se edhe për Kosovën mbrojtja e të dhënave personale është tejet e rëndësishme për çfarëdo hapi të mëturshëm në procesin e integritetit evropian. Deri më tani janë publikuar raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore që në një mënyrë apo tjetër shprehin mangësitë që ekzistojnë në këtë fushë. Raporti vjetor i Progresit i Komisionit Evropian vazhdimisht ka nënvizuar se Kosova ka arritur progres tejet të kufizuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.<sup>3</sup> Hapat e vetëm që i kanë marrë deri më tani institucionet e Kosovës në këtë fushë janë miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe emërimi i Mbikqyrësve Shtetëror të Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ndonëse me këtë veprim u zyrtarizuar themelimi i këtij Agjencioni, ky mekanizëm ende nuk është funksionalizuar. Për më tepër, duke ditur që ka pasur vetëm disa përparime të kufizuara në lëshimin e pasaportave biometrike, dhe këto lloj dokumentesh edhe më tutje nuk ka filluar të distribuohen tek qytetarët sugjeron se Kosova ende nuk ka arritur progres të duhur në plotësimin e kërkesave të BE-së në këtë fushë me qëllim të përafritimit sa i përket procesit të Integritetit Evropian e në radhë të parë atij të liberalizimit të vizave.

### >>> **Vështirësitë kryesore në mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë**

**P**ërkundër faktit se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është miratuar, kapacitetet aktuale të institucioneve shtetërore në lidhje me zbatimin e këtij ligji janë mjaft të ulëta. Deri më tani fusha e mbrojtjes së të dhënave personale është ballafaquar me vështirësi të ndryshme. Gjetjet e këtij hulumtimit tregojnë se që nga miratimi i këtij ligji e deri më tani kjo fushë është karakterizuar me:

- Mungesën e veprimeve përcjellëse për harmonizimin e legjislacionit;
- Vonesa të stërzgjatura në krijimin e mekanizmave për implementimin e kornizës ligjore;
- Mungesa e kapaciteteve profesionale;
- Niveli i ulët i vetëdijësimit tek të gjithë akterët e involvuar në këtë fushë;

#### **Mosharmonizimi i Legjislacionit**

Siç është përmendur më lartë, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u miratua nga Kuvendi i Kosovës më datë 29 Prill 2010. Ky ligj ishte hartuar me mbështetje të ekspertëve ndërkombëtarë dhe me përfshirjen shumë të kufizuar të vendorëve si rezultat i mungesës së ekspertëve vendor në këtë fushë. Në pikëpamje të

---

<sup>3</sup> Raporti i Progresit i Kosovës 2010, Komisioni Evropian, Bruksel, 9 Nëntor 2010, SEC (2010) 1329

përmbytjes, ky ligj është mjaft i avancuar, por vështirësitë janë evidente kur bëhet analizimi i ndërveprimit të këtij ligji me ligjet tjera që kanë ndërlidhshmëri të drejtëpërdrejtë me këtë fushë. Një numër i madh ligjesh të ndërlidhura direkt ose indirekt me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk janë të harmonizuara këtë ligj. Pjesa më e madhe tyre i përkasin periudhës së administrimit të Kosovës nga UNMIK-u<sup>4</sup>, periudhë kjo kur mbrojtja e të dhënave personale nuk ishte fare temë e ngritur për diskutim. Në listën e këtij legjislacioni që mund të jetë kundërtënës hyjnë ligje tejet të rëndësishme siç janë Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji mbi Telekomunikacionin, Ligji për Mbledhjen e të Dhënave Statistike, Ligji për Regjistrimin e Popullsisë dhe Pronës.

#### **Vështirësitë në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Procesi i zbatimit të këtij ligji është ende në fazën fillestare. Edhe pse Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dashur të themelohej më së voni deri në Nëntor 2010, themelimi i këtij agjencioni nuk ndodhi deri në fund të Qershorit 2011. Shkaktarë të kësaj ngecjeje ishin kryesisht kriza e fundit parlamentare e cila rezultoi me shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme qendrore e cila pati si rrjedhojë pezullimin e pjesës më të madhe të aktiviteteve të institucioneve shtetërore, andaj fat të njejtë pati edhe procesi i themelimit të Agjencionit.<sup>5</sup> Në fund të muajit Qershor, Kuvendi i Kosovës me shumicë të votave emëroi Këshillin Mbikqyrës të Agjencionit me ç'rast edhe u zyrtarizua themelimi i këtij Agjencioni si hap fillestar për implementimin e këtij ligji. Agjencioni ende gjendet në hapat fillestar të konsolidimit me qëllim të ushtrimit të misionit të tij për nxitjen e zbatimit të ligjit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Rëndësia për konsolidimin e këtij agjencioni është e shumëfishtë. Gjetjet e hulumtimit tregojnë se përkundër faktit që Agjencioni nuk ishte themeluar ende, vetëm kohëve të fundit u përmbyllën disa procese tejet të rëndësishme të mbledhjes së të dhënave personale pa asnjë mbikëqyrje të jashtme për sa i përket përmbytjes së standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Këtu vlen të përmenden Regjistrimi i Popullsisë dhe i Pronës dhe Regjistrimi i Numrave Mobil të Telefonit, procese këto me rëndësi strategjike u zhvilluan gjatë fillimit të vitit 2011 e që u zhvilluan tërësisht pa ndonjë mbikëqyrje adekuate të pavarur të nivelit të Agjencionit.

---

<sup>4</sup> Përveq legjislacionit që daton nga periudha e UNMIK-ut ka ende ligje në qv datojnë na periudha e ish-Jugosllavisë. Sipas drejtorit të Departamentit të Statistikave të Popullsisë, Instituti i Statistikave të Kosovës funksionon në bazë të ligjeve të miratuara nga periudha e ish-Jugosllavisë.

<sup>5</sup> Intervistë me Nurë Çeku, Zyrtar i Lartë, Kuvendi i Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri and FSK, 16 Maj 2011.

**Regjistrimi i Popullsisë** u zhvillua nga data 1 deri në 15 Prill 2011 me qëllim të regjistrimit të qytetarëve, familjeve dhe të pronave dhe për të mbledhur informacione të tjera të rëndësishme që mund të përdoren për këto lloje të grumbullimit të të dhënave në të ardhmen. Përderisa procesi u organizua në përputhje me Ligjin për regjistrimin e popullsisë dhe pronës, nuk kishte asnjë mekanizëm të pavarur për të mbikëqyrur këtë proces që e bën mjaft të diskutueshëm Regjistrimin e Popullsisë (Sojeva, 2011). Çfarë mund të konsiderohet brengosëse është se edhe pse të dhëna të rëndësishme janë mbledhur gjatë regjistrimit, gjatë përpunimit të këtyre të dhënave nuk kishte asnjë shenjë që Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është konsultuar. Zyrtarë të rëndësishëm që udhëheqin procesin e regjistrimit nuk ishin fare në dijeni për ekzistencën e këtij ligji e si rezultat ata mund të thuhet se nuk u morrën parasysh fare të drejtat e garantuara nga ky ligj.<sup>6</sup>

Një situatë e ngjashme ka ndodhur edhe gjatë procesit të **Regjistrimit të përdoruesve të telefonave mobil** i cili proces filloi në Tetor 2010 dhe përfundoi më 28 Shkurt 2011. Ky proces u drejtua në përputhje me Rregulloren për regjistrimin e numrave të përdoruesve mobil që hyri në fuqi më 1 Tetor 2010, nën mbikëqyrjen e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Megjithatë, në pyetjet e shtruar nga stafi ynë hulumtues për Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, asnjëri nga zyrtarët e lartë të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të përfshirë në procesin e këtij regjistrimi nuk ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e këtij ligji (Ajeti, 2011). Vlen të theksohet se ka pasur shqetësime të mëdha të shprehura nga qytetarët dhe shumë prej tyre hezituan të japin të dhënat e kërkuara për shkak të frikës se të dhënat e tyre personale mund të jenë subjekt i keqpërdorimit.<sup>7</sup>

### **Mungesa e kapaciteteve profesionale**

Kur flitet për kapacitetet profesionale për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka pothuajse mungesë të plotë të ekspertizës vendase në këtë fushë. Pothuajse të gjithë akterëve vendorë të involvuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale ju mungon ekspertiza në këtë fushë. Një gjë e tillë është e kuptueshme për vetë faktin se ligji është sapo miratuar, e për më tepër kjo fushë është veçanërisht e re jo vetëm

për Kosovën por edhe për rajonin në përgjithësi. Madje mungesa e ekspertizës ishte evidente edhe tek vet Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila ishte sponsoruesja e Ligjit, e të cilës i është dashur të kontrakttoj një ekspert ndërkombëtar që ta hartoj atë. Mungesa evidente të kapaciteteve profesionale në lidhje me këtë fushë ka edhe tek Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, pavarësisht involvimit të këtij komisioni që nga miratimi i ligjit, emërimit të Këshillit Udhëheqës të Agjencisë (Çeku, 2011).

### **Mungesa e vetëdijes**

Mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë është e garantuar me Kushtetutë. Neni 36 mbron privatësinë dhe garanton mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa neni 3 përcakton në mënyrë eksplicite se fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe mejteve tjera të komunikimit janë të drejta të pacenueshme. Ato në raste të caktuara mund të kufizohen vetëm për kohësisht dhe atë me vendim të gjykatës nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për vijimin e procedurës penale apo edhe për të garantuar sigurinë kombëtare të vendit, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Megjithatë, pavarësisht nga garancat që ofron Kushtetuta si dhe legjislacionet përkatëse në këtë fushë shumica e qytetarëve vazhdojnë të mos jenë të informuar për këto të drejta themelore civile, cenimi i të cilave prek integritetin e tyre personal. Pjesa më e madhe e qytetarëve vazhdojnë të mos jenë të informuar për ekzistimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për rëndësinë që ka implementimi i këtij ligji. Ekspozimi i qytetarëve ndaj cenimit të privatësisë në Kosovë mbetet veçanërisht i lartë. Deri më tani nuk ka pasur asnjë kriter për verifikimin e rasteve të grumbullimit të të dhënave personale në mënyrë të paautorizuar, sikurse edhe nuk ka pasur ndonjë kontroll adekuat për mënyrat se si procedohen të dhënat e grumbulluara në rastet kur ekziston një autorizim i tillë. Në këtë drejtim mungesë vetëdijësimi në lidhje me këtë fushë ka si nga ana e akterëve në sektorin publik apo privat që bëjnë grumbullimin e të dhënave personale në mënyrë të autorizuar ashtu edhe nga qytetarët e zakonshëm. Andaj në këtë kontekst Agjensionit duhet të marrë përsipër sa më parë që të informoj dhe këshilloj sektorin publik dhe privat për rëndësinë që paraqet mbrojtja e të dhënave dhe gjithashtu për të vetëdijësuar publikun e gjerë në lidhje me këtë fushë.

Në këtë kontekst bashkëpunimi i Agjensionit me akterë të ndryshëm është mjaftë i rëndësishëm. Sidomos bashkëpunimi i këtij agjensionit me shoqëri të civilë është i rëndësishëm jo vetëm shkak të mundësisë së kontraktimit të ekspertizës alternative por edhe për shkak të kapaciteteve që ata kanë në fushën e sensibilizimit dhe vetëdijësimit të qytetarëve. Deri më tani edhe shoqëria civile ka qenë në masë të madhe e papërfshirë në këtë.<sup>8</sup>

<sup>6</sup> Intervistë me Ibrahim Shabani, shefi i Entit Statistikor të Kosovës, 16 Maj 2011.

<sup>7</sup> Duke diskutuar me shumë qytetarë që punojnë në pozita të ndryshme kanë shprehur shqetësimet e tyre më të thella se regjistrimi i popullsisë mund të ketë efekt negativ për ta. Ata kishin frikë se informacionet e mbledhura mund të keqpërdoren për shkak të faktit se nuk ekzistonte asnjë mekanizëm i besueshëm i pavarur për monitorimin e përpunimit të të dhënave.

<sup>8</sup> Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë është në mesin e pak OJQ-ve të cilat janë përfshirë në mënyrë aktive në bërjen e

Megjithatë, përfshirja aktive e shoqërisë civile është kyçe në mënyrë që të avokojë për të drejtat e qytetarëve në mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, si një dimension i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

>>>

### Rekomandimet

#### Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

- Agjensioni duhet të i konsolidoj kapacitetet e tij të plota në mënyrë sa më urgjente;
- Agjensioni në mënyrë urgjente duhet të fillojë kampanja informuese si për opinionin e gjerë ashtu edhe për institucionet publike apo private që merren me grumbullimin e të dhënave personale;
- Agjensioni duhet të rishikojë proceset e përmbyllura të koleksionimit të të dhënave personale me qëllim të sigurimit të qytetarëve që ata nuk do të jenë subjekt i keqpërdorimeve të mundshme;<sup>9</sup>

#### Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe FSK

- Duhet të mbikqyrë në mënyrë intensive procesin e implementimit të Ligjit të të Dhënave Personale me qëllim të nxitjes së akterëve të involvuar (Agjensioni, ofruesve të të dhënave dhe grumbulluesve të tyre) që të fillojnë menjëherë me procesin e implementimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Edhe pse në fund të Qershorit 2011 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka themeluar bordin e saj ekzekutiv (Kuvendi i Kosovës, 2011), Kuvendi duhet të ndërmer masa të mëtutjeshme që të shtyjë këtë mekanizëm deri te konsolidimi sa më i shpejt i tij, në mënyrë që të fillojnë të ushtrojnë detyrat e tyre sipas ligjit;
- Duhet sa më shpejtë që të ndërmerren masat për harmonizimin e legjislacionit, veçanërisht të atyre ligjeve që janë miratuar para shpalljes së pavarësisë (Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji mbi Telekomunikacion, etj);

#### Qeveria e Kosovës

- Qeveria duhet të fillojë lëshimin e pasaportave biometrike sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo do të mundësojë implementimin e një pjesë të rëndësishme të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili është i lidhur edhe me liberalizimin e vizave.

---

politikës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke filluar nga pjesëmarrja në procesin e hartimit të ligjit.

<sup>9</sup> Ky rekomandim i referohet: Regjistrimit të popullsisë dhe Regjistrimit të numrave mobil.

#### Shoqëria Civile

- Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Media duhet të jenë më tepër të angazhuara në promovimin dhe rëndësinë e zbatimit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Kjo mund të bëhet përmes publikimit të studimeve, raporteve, organizimit të fushatave, raporteve të lajmeve, debateve publike, etj.

#### Bibliografia

<<<

#### Intervistat

1. Intervistë me Adem Gashi, hulumtues në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) 10 Maj 2011
2. Intervistë me Agron Behrami, Shef i Divizionit për Mbikëqyrjen e Pronës dhe Dhuratave, 13 Maj 2011
3. Intervistë me Ibrahim Shabani, Shef i Entit Statistikor të Kosovës, 16 Maj 2011
4. Intervistë me Kadri Sojeva, Drejtor i Departamentit të Statistikave të Popullsisë, 16 Maj 2011
5. Intervistë me Nurë Çeku, Zyrtar i Lartë, Kuvendi i Kosovës, Komisioni për Punë të Brendshme, të Sigurisë dhe të FSK-së, 16 Maj 2011
6. Intervistë me Rrezarta Ajeti, Zyrtare Ligjore / Departamenti i Telekomunikacionit, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, 17 Maj 2011
7. Intervistë me Zymer Maxharri, Kryeshef Ekzekutiv i Entit Statistikor të Kosovës, 16 Maj 2011

#### Dokumentet Ligjore

8. Direktiva 95/46 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit
9. Projektligji për Ndryshimin e Ligjit të Telekomunikacion, Qershor 2008
10. Vendimi i Kuvendit të Kosovës për emërimin e Këshillit Mbikëqyrës së Agjencisë Kosovare të Shtetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 24 Qershor 2011
11. Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Lejen e Sigurisë, Kuvendi i Kosovës, 1 Korrik 2010
12. Ligji mbi Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë dhe Dhuratat e Zyrtarëve të Lartë Publik, Kuvendi i Kosovës, 11 Shkurt 2010
13. Ligji mbi Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, Tetor 2010
14. Ligji mbi Telekomunikacionin, Maj 2003
15. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Kuvendi i Kosovës, 29 Dhjetor 2009
16. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi i Kosovës, 29 Prill 2010
17. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 6 Korrik 2003
18. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 6 Korrik 2003
19. Rregullorja për regjistrimin e përdoruesve të telefonisë mobile, Tetor 2010

20. Udhërrëfyese për regjim të lire të vizave për Bosnjën dhe Hercegovinën, Komisioni Evropian, 2010

### **Reportet dhe Revistat**

21. Raporti i Progresit të Kosovës 2010, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011 Bruksel, 9 Nëntor 2010

### **Internet**

22. Komisioni Evropian

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

---

**Email:** [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org)

**Web:** [www.qkss.org](http://www.qkss.org)

**Tel.:** +381 (0) 38 221 420

---